

V E N D I M
Nr.31, datë 14.4.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Perikli Zaharia	Anëtar
Kristaq Ngjela	“
Ylvi Myrtja	“
Agron Lamaj	“
Natasha Sheshi	“
Nikoleta Kita	“
Spiro Spiro	“
Artan Hoxha	“
Irma Bala	“
Valentina Kondili	“
Vladimir Metani	“
Bashkim Caka	“
Evjeni Sinoimeri	“

në seancat gjyqësore të datave 26.3.2003 dhe 14.4.2003 morën në shqyrtim çështjen nr.38 që i përket:

PADITËS:PAULIN CUNI, i datëlindjes 1968, lindur dhe banues në Theth, Dukagjin Shkodër, përfaqësuar nga avokat Haki Kraja.

I PADITUR:DREJTORIA E POLICISË SË QARKUT SHKODËR, në mungesë
OBJEKTI I PADISË:Anulim i urdhrit nr.298 datë 22.4.2002 të Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër

Baza ligjore: Nenet 31 e 32 të Kodit të Procedurës Civile.
Neni 32/5 i ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr.1068, datë 2.10.2002 ka vendosur:
“Anulimin tërësisht të urdhërit nr.298, datë 22.4.2002 të Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër.

Detyrimin e të paditurit, Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër të rimarrë në polici në rolin bazë, paditësin Paulin Cuni, duke i paguar atij pagën që nga data 5.4.2002 deri në datën e rikthimit në punë”.

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.329, datë 25.11.2002 ka vendosur:
“Ndryshimin e vendimit nr.1068 datë 2.10.2002 të Gjykatës së Rrethit Shkodër dhe rrëzimin e padisë”.

Kundër vendimit nr.329, datë 25.11.2002 të Gjykatës së Apelit Shkodër ka ushtruar rekurs paditësi Paulin Cuni, i cili parashtron:

Gjykata e apelit ka dhënë një vendim haptazi në kundërshtim me ligjin.

Vendimi i gjykatës së apelit është pa arsyetim.

Gjykata e apelit nuk është shprehur për themelin e çështjes, nëse urdhri i lirimit nga detyra është i ligjshëm apo jo.

Gjykata e apelit ka lënë të pazgjidhur konfliktin.

Nuk është e vërtetë se nuk është kërkuar e drejta e pagës, e drejta e pagës është kërkuar me padi dhe gjatë gjyqimit, si dhe në kërkesat përfundimtare.

Kur akti administrativ vjen në kundërshtim me ligjin, gjykata duhet të rregullojë pasojat.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relacionin e gjyqtarëve Ylvi Myrtja dhe Kristaq Ngjela, avokatin e paditësit, i cili kërkoji prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë ose kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e apelit, në mungesë të palës së paditur, si dhe pasi biseduan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë:

Paditësi Paulin Cuni ka qenë efektiv i Komisarariatit të Policisë Shkodër me detyrë kujdestar në postën kufitare të nënseksionit të Policisë Kufitare të këtij komisarati.

Me propozimin nr.144, datë 16.4.2002 të Komisarariatit të Policisë Shkodër dhe vendim të Këshillit Emërues të Policisë së Qarkut Shkodër, Drejtori i Policisë së Qarkut Shkodër e ka përjashtuar nga policia paditësin, me urdhrin nr.298, datë 22.4.2002. Në urdhër thuhet: “Nënoficer Paulin Kol Cuni, deri tani me detyrë kujdestar-magaziniër në PPK Theth në nënseksionin e Policisë Kufitare në Komisaratin e Policisë Shkodër, të përjashtohet nga policia me motivacionin “Për mosparaqitje në detyrë mbi shtatë ditë”. Marrëdhëniet administrative financiare t’i ndërpriten më datën 5.4.2002”.

Urdhri nr.298, datë 22.4.2002 të Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër, paditësi e ka kundërshtuar në gjykatë. Në kërkesëpadinë që ka paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër, paditësi pretendon:

Urdhri nr.298, datë 22.4.2003 i Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër nuk është i bazuar në ligj e në prova.

Nuk është e vërtetë që të kem munguar në detyrë mbi shtatë ditë.

Kërkimet paditësi i ka bazuar në nenet 31 e 32 të Kodi të Procedurës Civile, në nenin 12 të ligjit nr.1188, datë 10.8.1995 dhe nenit 32/5 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Gjatë gjykimit, përveç pyetjes së dëshmitarëve, gjykata ka administruar propozimin nr.144, datë 16.4.2002 të Shefit të Komisarariatit të Policisë Shkodër, propozimin e datës 18.4.2002 të Këshillit Emërues të Qarkut të Policisë, urdhrin nr.298, datë 22.4.2002 të Drejtorit të Policisë të Qarkut Shkodër, listë prezencën e efektivit të PPK Theth për periudhën 1.4.2002 deri më 15.4.2002 dhe trembëdhjetë fletë të shkëputura nga libri i shërbimit.

Paditësi ka kërkuar: “Anulimin e urdhrit nr.298, datë 22.4.2002, rikthimin në punë dhe pagesën deri në rimarrjen në punë” me arsyetimin se pretendimi i ngritur prej tij se nuk ka munguar më shumë se shtatë ditë është provuar si nga shpjegimet e dëshmitarëve, ashtu edhe nga provat e paraqitura nga pala e paditur si libri i shërbimit PPK Theth, praktika disiplinore dhe vlerësimi, që i është bërë punës së tij.

Në përfundim të gjykimit Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër ka vendosur anulimin e urdhrit nr.298, datë 22.4.2002, objekt gjykimi, detyrimin e të paditurit të rimarrë në punë paditësin, duke i paguar pagën nga data 5.4.2002 deri në datën e kthimit në punë me këtë arsyetim:

Gjykata krijon bindjen se nuk është e vërtetë që paditësi Paulin Cuni nuk është paraqitur në detyrë mbi shtatë ditë, për pasojë urdhrin nr.298, datë 22.4.2002 të Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër për përjashtimin nga policia të paditësit Paulin Cuni e çmon të pabazuar në ligj, pasi nuk jemi para asnjë prej rasteve të përjashtimit nga policia, të parashikuar nga neni 20 pika 3/a e ligjit nr.8553, datë 25.11.1999.

Në nenin 32/5 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” parashikohet e drejta e të ndëshkuarve për t’u ankuar drejtpërdrejt në gjykatë, ndërsa në nenin 68/1 të të njëjtit ligj parashikohet që: “Trajtimi i punonjësve të policisë deri në plotësimin e akteve normative, të parashikuara në këtë ligj, bëhet sipas statusit të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” nuk tregon se çfarë mund të vendosë gjykata kur e gjen të drejtë ankimin e të ndëshkuarve, siç është rasti i paditësit Paulin Cuni, por referon tek statusi i ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Në ligjin nr.8670, datë 26.10.2000 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, neni 28 pika 3 thuhet: “Kur akti i shfuqizuar nga gjykata ka të bëjë me nxjerrjen në rezervë ose me lirimin e ushtarakut nga Forcat e Armatosura, ai ka të drejtë të rikthehet në

detyrën e mëparshme ose në një detyrë tjetër të njëjtë me atë të mëparshmen”.

Gjykata çmon se urdhri nr.298 është akt administrativ, që nuk bën pjesë në aktet administrative të parashikuara nga neni 326 i Kodit të Procedurës Civile, ndaj të cilëve nuk mund të ngrihen padi në gjykatë, prandaj konform nenit 325 të Kodit të Procedurës Civile e gjen të drejtë kërkesën e paditësit Paulin Cuni për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga urdhri objekt gjykimi.

Në përfundim, gjykata çmon se duhet të anulohet urdhri nr. 298 i Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër, datë 22.4.2002 dhe paditësi Paulin Cuni të rikthehet në polici, në rolin bazë, duke u dëmshpërblyer me shumën e lekëve të barabartë me pagën që nga dita e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare 5.4.2002 deri më datën e rifillimit të detyrës në rolin bazë në polici.

Vendimi i dhënë nga gjykata e rrethit është apeluar nga Drejtori i Policisë së Qarkut Shkodër. Në apelim pretendohet:

Urdhri objekt gjykimi, që i është anuluar nga gjykata e shkallës së parë, është bazuar në dokumentacionin që është paraqitur nga nënseksioni i Policisë Kufitare të Komisarariatit Shkodër.

Në relacionin sqarues të përpiluar nga kapiteni i parë Ndrej Brushtulli, me detyrë komandant i PPK Theth, ku shërbente paditësi dhe e sigluar nga shefi i nënseksionit të Policisë Kufitare të Komisarariatit Shkodër, kapiteni i parë Rakip Hasa shprehet qartë se deri më datën 12.4.2002 nga paditësi kishte mosparaqitje në punë për nëntë ditë.

Për këto mungesa të paditësit janë njoftuar çdo ditë komandanti i PPK Theth dhe shefi i nënseksionit të Policisë Kufitare nga efektivitë dhe policisë në postë dhe komunikimi me radio.

Në seancën gjyqësore të datës 27.9.2002 kemi kërkuar riçeljen e hetimit gjyqësor për marrjen dhe një herë në pyetje të policëve të PPK Theth, Nikolin Guri, Arben Shkëmbi, Besnik Qarku dhe Lush Blinishta, por kjo kërkesë e jona nuk u pranua padrejtësisht nga gjyqtari.

Ripyetja e katër policëve të mësipërm është e domosdoshme se në librin e planizimit të shërbimit 24 orësh të PPK Theth, është bërë fallsifikim duke u plotësuar pas datës 14.4.2002. Kjo vërtetohet nga ndryshimet në shkrim, si dhe nga ripohimet e policëve.

Më datën 25.11.2002, gjykata e apelit pasi ka dëgjuar paditësin dhe avokatin e tij në mungesë të palës së paditur ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë me arsyetimin:

Në vendimin nr.37, datë 29.5.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është mbajtur ky qëndrim:

“Megjithatë me anën e ankimit në gjykatë ushtaraku apo punonjësi i policisë ... nuk mund të realizojë rikthimin në detyrën që ka pasur edhe kur është larguar prej saj për shkaqe të përligjura, por mund të realizojë të drejtën për t’u kompensuar financiarisht për dëmet e shkaktuara nga ndërprerja e kontratës së shërbimit nëpunësit publikë të kësaj kategorie në asnjë rast nuk mund të mbrohen me padi për rikthimin në detyrën që kishin”. Në këtë kuptim kthimi në detyrë si polic i paditësit nga gjykata është i gabuar.

Paditësi në ngritjen e padisë nuk ka kërkuar dëmshpërblimin për kohën e qëndrimit pa punë, kështu që gjykata e apelit në bazë të nenit 6 të Kodit të Procedurës Civile nuk mund të shprehet për këtë, megjithëse largimin nga puna të paditësit Paulin Cuni, gjykata e ka quajtur të padrejtë.

Me vendimin e datës 22.1.2003 Kryetari i Gjykatës së Lartë ka vendosur që rekursi i paraqitur nga paditësi Paulin Cuni kundër vendimit të gjykatës së apelit të shqyrtohet në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të unifikuar praktikën gjyqësore për faktin se vazhdojnë të mbahen qëndrime të ndryshme nga gjykata të shkallëve të ndryshme.

Në vendimin për kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë thuhet: “... në nenet 29 dhe 32 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” u njihet vetëm e drejta e ankimit në gjykatë, pa u shprehur për të drejtën e rikthimit në punë. Në pikën 3 të nenit 28 të ligjit nr.8670, datë 26.10.2000 “Për gradat dhe karrierën e ushtarakëve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” thuhet: “Kur akti i shfuqizuar nga gjykata ka të bëjë me nxjerrjen në rezervë ose me lirimin e ushtarakut nga Forcat e Armatosura, ai ka të drejtë të rikthehet në detyrën e mëparshme ose në një detyrë tjetër të njëjtë me atë të mëparshmen”. Gjykatat konsiderojnë ushtarak edhe punonjësin e policisë, për këtë arsye zbatojnë ligjin për ushtarakët.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se një pjesë e pretendimeve të ngritura në rekurs qëndrojnë. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi nga gjykata e apelit është zbatuar keq ligji.

Objekti i mosmarrëveshjes i pretenduar nga paditësi ka qenë ligjshmëria e urdhrit nr.298, datë 22.4.2002 të Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër. Sipas paditësit, ky urdhër nuk është i bazuar në

ligj e në prova. Gjykata e shkallës së parë ka pranuar pretendimet e paditësit, ka anuluar urdhrin dhe detyruar të paditurin të rimarrë në punë paditësin. Gjykata e apelit nuk është shprehur nëse urdhri është i ligjshëm apo jo. Pa u shprehur për themelin gjykata e apelit ka rrëzuar padinë, si të pabazuar në ligj e në prova me arsyetimin se paditësi nuk mund të rikthehej në punë.

Gjykata e apelit e kishte për detyrë të kryente një hetim gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm e në përputhje me ligjin (neni 14 i Kodit të Procedurës Civile) për të sqaruar nëse urdhri i Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër është në pajtim ose në kundërshtim me ligjin. Në zbatim të kësaj detyre, gjykata e apelit mund të përsëriste tërësisht apo pjesërisht hetimin gjyqësor me të drejtën për të marrë edhe prova të reja (neni 465 i Kodit të Procedurës Civile). Duke mos u shprehur për ligjshmërinë e urdhrin të Drejtorit të Policisë, gjykata e apelit ka lënë pa zgjidhur mosmarrëveshjen objekt gjykimi (neni 16 i Kodit të Procedurës Civile).

Për pasojë, vendimi i gjykatës së apelit duhet të prishet dhe çështja duhet të dërgohet përsëri për rishqyrtim në gjykatën e apelit. Meqenëse gjykata e apelit nuk e ka shqyrtuar themelin e çështjes, ajo është e detyruar ta rigjykojë edhe një herë këtë çështje dhe të verifikojë, nëse është shkelur apo nuk është shkelur ligji nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër. Në zbatim të dispozitave që cituam më sipër gjykata e apelit duhet të shqyrtojë si faktin dhe ligjin.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse ka ekzistuar një “kontratë e shërbimit publik”. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë dhe udhëzojnë (neni 486 i Kodit të Procedurës Civile) se kur “kontrata e shërbimit publik” zgjidhet dhe zgjidhja e kësaj kontrate është në përputhje me ligjin, nuk shtrohet për diskutim asnjë problem. Probleme lindin kur zgjidhja e kontratës është në kundërshtim me ligjin. Kur kontrata zgjidhet në kundërshtim me ligjin shtrohet për diskutim:

A mund të vendoset gjyqësisht rikthimi në punë i të larguarit nga puna apo në raste të tilla vetëm do të dëmshpërblehet për pushimin e padrejtë nga puna?

Dëmshpërblimi duhet të kërkohet në mënyrë të shprehur apo mjafton kundërshtimi i zgjidhjes së kontratës, që të shqyrtohet edhe dëmshpërblimi?

Si do të llogaritet dëmshpërblimi për pushimet e padrejta nga puna?

Duhet të kemi parasysh se për punonjësit që merren në radhët e policisë ndodhemi përpara një marrëdhënie kontraktore në formën e kontratës së shërbimit publik. Kushtet e kontratës parashikohen në ligjin “Për Policinë e Shtetit”. Në këtë ligj parashikohet statusi i punonjësit të policisë (neni 15), pranimi në radhët e policisë (neni 16), emërimi dhe lirim (neni 19), largimet dhe përjashtimet (neni 20), masat disiplinore (neni 29) dhe ankimet për largimin ose përjashtimin nga policia (neni 32). Paditësi është larguar nga policia në bazë të gurmës “b” të pikës “3” të nenit 20. Në këtë dispozitë thuhet: “Punonjësi i policisë përjashtohet nga policia, kur nuk paraqitet në detyrë, pa shkaqe të arsyetuara mbi 7 ditë”. Me këtë arsyetim është zgjidhur “kontrata e shërbimit publik” nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër.

Në lidhje me zgjidhjen e kësaj kontrate, gjykata e shkallës së parë arsyeton: Ligji “Për Policinë e Shtetit” nuk tregon se çfarë mund të vendosë gjykata kur e gjen të drejtë ankimin e të ndëshkuarve, siç është rasti i paditësit, por të referon tek statusi i ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Sipas gjykatës referenca del nga neni 68/1 i ligjit “Për Policinë e Shtetit” në të cilin thuhet: “Trajtimi i punonjësve të policisë deri në plotësimin e akteve normative, të parashikuara në këtë ligj bëhet sipas statusit të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, gjykata e shkallës së parë nuk i është referuar ligjit nr.7978 datë 26.7.1995 “Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, por ligjit nr.8670, datë 26.10.2000 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Dispozitat e këtij ligji nuk janë të detyrueshme për punonjësit e policisë, ato janë të zbatueshme vetëm për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në bazë të Kushtetutës së Shqipërisë (neni 168/1), punonjësit e policisë nuk bëjnë pjesë në Forcat e Armatosura. Në nenin 15/1 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” është sanksionuar: “Statusi i punonjësit të policisë rregullohet me këtë ligj ...”.

Për të kuptuar më saktë statusin e punonjësve të policisë duhet t’i referohemi patjetër nenit 1 dhe 2 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” ku është përcaktuar: “Policia e Shtetit, në vijim e shprehur “Policia”, është institucion i administratës shtetërore të Republikës së Shqipërisë, në varësi të Ministrit të Rendit Publik, që ka për mision të mbrojtë rendin dhe sigurinë publike, si dhe të garantojë

zbatimin e ligjit ... Statusi i policisë, i përcaktuar në këtë ligj, nuk ndryshon edhe në kushtet e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme apo të rasteve të fatkeqësive natyrore”.

Ndërsa neni 1 i ligjit “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” përcakton: “Ky ligj përcakton kriteret dhe autoritetin për pranimin në gradë dhe në karrierë, përgjegjësitë që rrjedhin nga karakteri i veçantë i detyrës dhe i shërbimit ushtarak dhe ndërprerjen e karrierës për ushtarakët e Forcave të Armatosura”.

Referimi tek ky ligj është i gabuar. Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj...” (neni 16 i Kodit të Procedurës Civile). Për gjykatën që do të rigjykojë këtë çështje janë të detyrueshme të zbatohen dispozitat ligjore të ligjit të posaçëm për Policinë e Shtetit.

Sipas ligjit “Për Policinë e Shtetit”, kur zgjidhet kontrata e shërbimit publik nuk shtrohet fare për diskutim problemi i mundësisë së vendosjes në rrugë gjyqësore të detyrimit për rilidhjen e kësaj kontrate, nëse konkludohet se është zgjidhur në mënyrë të paligjshme. Rilidhja e kontratës së shërbimit publik mund të bëhet vetëm me vullnetin e palëve. Kur njëra nga palët nuk jep pëlqimin, kontrata nuk mund të rilidhet. Ligji për policinë nuk ka ndonjë urdhërim për rimarrjen në punë. Meqenëse kemi një ligj të posaçëm, siç është ligji për policinë, edhe mosmarrëveshja objekt gjykimi duhet të zgjidhet në përputhje me këtë ligj (neni 16 i Kodit të Procedurës Civile).

Ligji për policinë nuk e njeh rikthimin në punë. Ky ligj nuk i ka dhënë të drejtën gjykatës për të rikthyer në punë punonjësit e larguar nga radhët e policisë.

Rikthimi në punë është në diskrecionin e administratës së policisë dhe ky diskrecion nuk i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor. Rikthimi ose jo i të larguarit nga puna është në çmimin e administratës së policisë në Qarkun e Shkodrës. Vetëm Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër mund ta rimarrë në punë paditësin.

Nga ana tjetër, punëdhënësi apo një organ administrativ më i lartë nga varet punëdhënësi, mund ta çmojë që ta rimarrë punëmarrësin në punën e mëparshme apo në një punë tjetër të përafërt me të. Në raste të tilla ai mund të bindet për paligjshmërinë e largimit nga puna dhe të vendosë rikthim të plotë të të drejtave të të punësuarit.

Si përfundim, me anë të ankimit në gjykatë punonjësi i policisë, ashtu si dhe një numër tjetër punonjësish publikë që kanë detyra të caktuara shërbimi ndaj shtetit, për shkak të të cilave veprojnë si përfaqësues të shtetit për mbrojtjen e interesave të tij, nuk mund të realizojnë gjyqësisht rikthimin në detyrën që kanë pasur, edhe në qoftë se provohet se janë larguar prej saj pa shkaqe të përligjura.

Në këto raste e drejta e rikthimit në punë nuk konsiderohet një e drejtë themelore, në kuptimin që u jep të drejtave të tilla Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, mbrojtja gjyqësore e të cilave është e garantuar. Sidoqoftë, ligjvënësi nuk ka pengesë që të miratojë një ligj për t'i dhënë mbrojtje gjyqësore edhe kësaj të drejte. Megjithatë, deri më sot, nuk e ka çmuar të sigurojë e të garantojë një mbrojtje të tillë. Aktualisht ligji “Për Policinë e Shtetit” nuk siguron një mbrojtje më të madhe se standardi minimum i konventës. Gjykatës që shqyrton këto mosmarrëveshje me këtë ligj nuk i zgjerohet hapësira, përkundrazi i ngushtohet. Sa më lart është një qëndrim konsequent i Gjykatës së Lartë, i cili është në pajtim me jurisprudencën (case law) të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, të cituar edhe në vendime të tjera. Përsërisim se në vendimin e Gjykatës së Strasburgut, në çështjen Pellegrin kundër Francës, kjo gjykatë, ndër të tjera, arsyeton si më poshtë: “... në sektorin publik të çdo vendi disa poste kanë të bëjnë me përgjegjësi, që janë në interesin e përgjithshëm ose me pjesëmarrje në ushtrimin e pushteteve që jepen prej të drejtës publike. Mbajtësit e posteve të tilla në këtë mënyrë përdorin një pjesë të pushtetit sovran të shtetit. Për rrjedhojë, shteti ka një interes legjitim për të kërkuar prej këtyre nëpunësve një detyrim të veçantë besimi dhe besnikërie. Nga ana tjetër, në lidhje me postet e tjera, të cilat nuk kanë këtë aspekt të “administrimit publik”, nuk ka interes të tillë”

Për rrjedhojë, gjykata vendos që të vetmet mosmarrëveshje që përjashtohen prej përmbajtjes së nenit 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut janë ato që ngrihen nga nëpunësit publikë, detyrat e të cilëve tipizojnë aktivitetet specifike të shërbimit publik, për aq sa ky i fundit vepron si depozitar i autoritetit publik, që është përgjegjës për mbrojtjen e interesave të përgjithshme të shtetit ose të autoriteteve të tjera publike. Një shembull i shprehur qartë i aktiviteteve të tilla është rezervuar për forcat e armatosura dhe policinë”

E drejta e rikthimit në punë nuk gëzon mbrojtje gjyqësore, ndërsa e drejta e dëmshpërblimit

është një e drejtë që gëzon mbrojtje. Pala që dëmtohet nga një pushim i padrejtë nga puna gëzon të drejtën e dëmshpërblimit në rrugë gjyqësore.

Një konkluzion i tillë del edhe nga neni 44 i Kushtetutës sipas të cilit: “Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore”.

Ndërsa Kodi i Punës shprehet qartë se çfarë bëhet kur zgjidhet në mënyrë të padrejtë kontrata e punës (neni 146/3 i Kodit të Punës), në ligjin “Për Policinë e Shtetit” thuhet: “Dëmi material i shkaktuar zhdëmtohet sipas akteve normative përkatëse” (neni 29/2). Mungesa e akteve normative nuk mund të shërbejë si argument për të refuzuar shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi (neni 1/2 i Kodit të Procedurës Civile).

Zgjidhja e kontratës së shërbimit publik pa shkaqe të arsyeshme sjell si pasojë përgjegjësinë e punëdhënësit të zhdëmtojë punëmarrësin për dëmet e pësuar nga zgjidhja e kontratës, duke e vënë atë në atë gjendje pasurore që do të ishte po të mos ishte larguar nga radhët e policisë.

Gjykata që shqyrton largimin e policit nga puna nuk shqyrton kontratën e punësimit. Ajo është zgjidhur në mënyrë të njëanshme. Ajo dëmshpërblen palën që është dëmtuar, në qoftë se gjatë gjykimit do të rezultojë se zgjidhja e njëanshme e kontratës është e pabazuar në ligj. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, edhe në çështjen *Niegel kundër Francës* pranon se paditë që lidhen me pagat apo përfitimet e tjera financiare nuk janë të lidhura domosdoshmërisht me paditë për rikthimin në detyrë ... Pagat, pensionet dhe përfitime të tjera sipas kontratës së shërbimit publik, nuk janë të lidhura me ndonjë pushtet diskrecional. Diskrecioni mund të ushtrohet vetëm në lidhje me rekrutimin ose mbarimin e kontratave publike, por jo për rrjedhojat ekonomike që vijnë prej tyre.

Këto të drejta të karakterit privat (që nuk lidhen me të drejtën publike), mund të mbrohen në gjykatë si të gjitha të drejtat e tjera civile.

I larguari nga radhët e policisë ka të drejtë të kërkojë vetëm shpërblimin e dëmit, pasi rikthimi në punën e mëparshme mund të bëhet vetëm me vullnetin e punëdhënësit. Për sa kohë punëdhënësi nuk ka vullnet për ta rimarrë në punë, kontrata e shërbimit publik nuk mund të rilidhet. Kontrata e shërbimit publik, duke qenë veprim juridik duhet të jetë rezultat i shprehjes së vullnetit të lirë të palëve. Por vlen të theksohet se pala që ka zgjidhur kontratën pa shkaqe të arsyeshme detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim.

Në lidhje me sa u argumentua më sipër Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se nuk është e nevojshme të kërkohet në mënyrë të shprehur dëmshpërblimi. Për rastet kur punonjësit e policisë kundërshtojnë zgjidhjen e kontratës së shërbimit civil, mjafton të kundërshtohet akti me të cilin është zgjidhur kontrata dhe gjykata duhet të marrë në shqyrtim edhe pasojat që vijnë nga zgjidhja e paligjshme e kontratës d.m.th. dëmshpërblimin. Megjithatë, si në çdo rast tjetër, i takon paditësit barra për të provuar sasinë e dëmit që i është shkaktuar.

Kur kontrata e punës zgjidhet pa shkaqe të arsyeshme, punëdhënësi duhet të paguajë një shumë të hollash që të përfaqësojë dëmin e pësuar. Shpërblimi i dëmit ka për qëllim të zëvendësojë dëmin e pësuar nga zgjidhja e padrejtë e kontratës së punës, prandaj ky zhdëmtim duhet të jetë i plotë.

Dëmshpërblimi në vend të rikthimit në punë do të thotë se “shkaktuesi i dëmit” do të paguajë një shumë të hollash që do ta vendosë të larguarin nga puna në atë gjendje pasurore që do të ishte, po të mos ishte larguar nga puna. Parimi i shpërblimit të plotë të dëmit është një parim themelor. Shpërblimi i plotë i dëmit do të thotë që sasia e shpërblimit të jetë në pajtim me masën e dëmit të shkaktuar.

Largimi nga puna është i lidhur me ndërprerjen e pagës. Mosmarrja e pagës ndikon në kushtet materiale të jetës së punonjësit dhe familjes së tij. Pagat e humbura ose të pakësuar duhet të shpërblehen. Në këto raste dëmshpërblimi duhet për të përballuar kushtet materiale të jetës për atë kohë, brenda së cilës çmohet se punëmarrësi mund të gjejë një punë tjetër. Gjykata në çdo rast, sipas diskrecionit të saj, me vendimin që jep bën një vlerësim paraprak të dëmit të pësuar nga punëmarrësi. Ndërsa Kodi i Punës në raste analoge ka përcaktuar si vlerë maksimale të dëmshpërblimit pagën e një viti, për këtë kategori të punësuarish nuk kemi të fiksuar në ligj të posaçëm ndonjë kriter apo kufi vlerësimi. Për rrjedhojë, është në diskrecionin e gjykatës për të vendosur një masë të arsyeshme dëmshpërblimi, duke u nisur nga rrethanat konkrete të çdo rasti të veçantë.

Në lidhje me masën e dëmshpërblimit që pretendon, paditësi ka detyrimin që në përputhje me

ligjin, të provojë faktet, mbi të cilat bazon pretendimet e tij (nenet 8, 12 e 213 e vijues të Kodi i Procedurës Civile).

Në rigjykim, gjykata e apelit duhet të verifikojë, nëse kontrata e shërbimit është zgjidhur në pajtim apo në kundërshtim me ligjin. Në funksion të përfundimeve që do të dalin pas hetimit gjyqësor, do të zgjidhen edhe problemet e shtruara për diskutim.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 485/c të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S Ë N

Prishjen e vendimit nr.329, datë 25.11.2002 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Shkodër me tjetër trup gjykues.

Ky vendim për njësimin e praktikës gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I GJYQTARËVE NË PAKICË

Pakica ka mendimin se vendimi i marrë nga shumica e gjyqtarëve në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke e dërguar çështjen me paditës Paulin Cuni për rishqyrtim në gjykatën e apelit dhe arsyetimi se gjykata nuk ka të drejtë të marrë vendim për kthimin në punë të një punonjësi të policisë, edhe kur ajo konstaton se është përjashtuar padrejtësisht nga detyra nuk janë të bazuara në ligj dhe nuk mbron të drejtat e njohura me ligj për punonjësit e policisë.

Nga aktet që ndodhen në dosje, rezulton se paditësi Paulin Cuni ka qenë polic efektiv i komisarariatit në nënseksionin e Policisë Kufitare në PPK Theth dhe me propozim të Këshillit Emërues të Qarkut Shkodër, me urdhërin nr. 298, datë 22.4.2002 të Drejtorit të Policisë së Qarkut, është përjashtuar nga detyra me arsyetimin se nuk është paraqitur në detyrë mbi 7 ditë.

Mbi padinë e Paulin Cunit me objekt anulimin e urdhrit të mësipërm, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi ka shqyrtuar çështjen dhe ka arritur në përfundimin se nuk është e vërtetë që paditësi nuk është paraqitur në detyrë mbi 7 ditë e se për pasojë urdhri për përjashtimin e paditësit nga detyra nuk qëndron, se nuk ndodhemi para asnjë nga rastet që parashikon neni 20 pika 3 e ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, që bën fjalë për largimet dhe përjashtimet nga policia, ka anuluar urdhrin duke vendosur dhe detyrimin e të paditurit të rimarrë në polici në rolin bazë paditësin Paulin Cuni.

Vendimi i gjykatës së rrethit është ndryshuar me vendim të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe është rrëzuar padia me arsyetimin se me anë të ankimit në gjykatë, ushtaraku apo punonjësi i policisë, nuk mund të realizojë kthimin në detyrën e mëparshme, arsyetim ky që pranohet edhe nga shumica në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Duke pasur parasysh trajtimin e bërë para gjykatës shtrohen si probleme:

a) nëse punonjësi i policisë që përjashtohet nga policia, ka të drejtë të ankojë urdhrin përkatës në gjykatë e të kërkojë anulimin e tij kur pretendon se është i padrejtë?

b) gjykata që shqyrton çështjen a ka të drejtë të vendosë për kthimin e policit në detyrën e mëparshme?

Për t’iu dhënë përgjigje këtyre pyetjeve është e nevojshme që në radhë të parë, t’i drejtohem Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë duke përmendur nenin 42 të saj, sipas të cilit “Kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ... ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”. Sikurse shihet, Kushtetuta shprehet për rivendosjen e të drejtave ligjore të cenuara dhe në këtë aspekt, (duke pasur parasysh dhe problemet që do trajtohen më poshtë) pakica ka mendimin se edhe urdhrat për përjashtimin e policit nga policia i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor dhe për pasojë, është në kompetencën e gjykatës që shqyrton çështjen që të nxjerrë përfundime për

ligjshmërinë e tyre e nëse i gjen të kundërligjshme, të vendosë për shfuqizimin e tyre.

Në bazë të nenit 168/1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, punonjësit e policisë nuk bëjnë pjesë në Forcat e Armatosura e veprimtaria e tyre ushtrohet në bazë të ligjit “Për Policinë e Shtetit”. Megjithëse edhe në bazë të këtij ligji, policia është institucion i administratës shtetërore, duhet pranuar se çdo punonjës policie gëzon mbrojtjen e të drejtave të tij në bazë të kritereve të përcaktuara në ligj.

Sipas nenit 20 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, punonjësi i policisë largohet nga policia (përcaktohen rastet) apo përjashtohet nga policia, kur thyen rëndë disiplinën, kur kryen thyerje të përsëritura të disiplinës, kur nuk paraqitet në detyrë pa shkaqe të arsyeshme mbi 7 ditë (neni 20/3/b) etj. Njëkohësisht, në pikën 4 të këtij neni, parashikohet e drejta e ankimit për largimin apo përjashtimin nga policia në përputhje me kriteret e caktuara në kreun 5 të ligjit e në nenin 31 të këtij kreu, përsëritet se në çdo rast punonjësit të policisë, ndaj të cilit është marrë masa disiplinore, i lind e drejta për të bërë ankim me shkrim te titullari i organit dhe në nenin 32 të ligjit parashikohen të drejtat e komisionit disiplinor që shqyrton ankesat disiplinore, të drejtën që ka ky komision që t’i propozojë titullarit të organit për ta rishikuar masën e dhënë dhe se vendimi i titullarit është i formës së prerë. Në pikën 5 të nenit 32 parashikohet e drejta e ankimit kundër vendimit të formës së prerë në gjykatë dhe se “për rastet e pikës “e” të nenit 29, ankimi mund të bëhet edhe drejtpërdrejt në gjykatë” (kjo ka të bëjë me përjashtimin nga policia).

Duke pasur parasysh sa u përmend, del qartë se punonjësi i policisë, për të cilin është marrë masë disiplinore përjashtimi nga policia, ka të drejtë që ankimin ta bëjë në gjykatë për të kundërshtuar vendimin e marrë nga titullari i organit.

Është e qartë se në rastin e marrjes së masës disiplinore “përjashtim nga policia”, kemi të bëjmë me zgjidhjen e kontratës së punësimit në mënyrë të njëanshme, por pakica ka mendimin se është i padrejtë arsyetimi i shumicës se rikthimi në punë nuk i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor, pasi ai është në diskrecionin e administratës së policisë dhe se rikthimi ose jo në punë i të larguarit apo të përjashtuarit nga policia është vetëm në të drejtën e saj.

Është e vërtetë se në nenin 32/5 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, njihet e drejta që në rastet e përjashtimit nga policia, ankimi mund të bëhet drejtpërdrejt dhe nuk parashikohet se çfarë mund të vendosë gjykata dhe a mund të shprehet ajo për rikthim në detyrë. Mendojmë se, pavarësisht se nuk shprehet për rikthim në punë, nuk është i drejtë arsyetimi se gjykata nuk e ka një të drejtë të tillë dhe se në rastet e shqyrtimit të një ankimi për përjashtim nga detyra, ajo ka vetëm të drejtë të konstatojë ose të vërë në dukje shkeljen e ligjit.

E drejta e ankimit në gjykatë kundër vendimit (urdhrit) për përjashtimin nga policia, është e drejtë personale, por ashtu si në çdo rast tjetër të shqyrtimit gjyqësor, ushtrimi i kësaj të drejte, e vë detyrimisht gjykatën para problemit të zgjidhjes së çështjes që shqyrton. Nuk mund të kuptohet roli i gjykatës dhe roli vendimmarrës i saj, vetëm me konstatimin apo vënien në dukje të shkeljes pa i dhënë rrugëzgjidhje çështjes në shqyrtim, përderisa ka të drejtën e shqyrtimit. Ligji nuk kufizon mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga gjykata e për pasojë, kur paditësi kërkon rikthimin në punë e mëparshme dhe gjykata e pranon të drejtë këtë zgjidhje, ajo ka të drejtë të vendosë për rikthimin në punë gjë që duhet pranuar si për gjithë rastet e tjera që ajo shqyrton çështjet që janë në kompetencë të saj. Kjo del edhe nga përmbajtja e nenit 112 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit “gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërtënie ose është i paqartë”. Arsyetimi i bërë më sipër mund të gjejë mbështetje edhe në ligjin nr.8670, datë 26.10.2000 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” në nenin 28 të të cilit parashikohet e drejta e ushtarakut që, kur mosmarrëveshjet nuk zgjidhen, të ankohet në gjykatë dhe se (pika 3) “Kur akti i shfuqizuar nga gjykata ka të bëjë me nxjerrjen në rezervë ose me lirim të ushtarakut, ai ka të drejtë të rikthehet në detyrën e mëparshme ose një detyrë tjetër të njëjtë me atë të mëparshmen”.

Duke pasur parasysh sa u përmend, pakica ka mendimin se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është i drejtë e i bazuar në ligj, ndaj duhej vendosur prishja e vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër e lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së rrethit.

Natasha Sheshi, Valentina Kondili, Kristaq Ngjela, Spiro Spiro, Vladimir Metani, Artan
Hoxha